



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1079/16 Prot.

Tirane, më 16.04 2024

VENDIM  
Nr. 23 dt. 16.04 2024

**“PËR  
MIRATIMIN E NGRITJES SË GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E DRAFT-RREGULLORES  
FINANCIARE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS.**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Ligjin nr. 9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; në Ligjin nr. 1 14/2015 "Per auditimin e brendshëm në sektorin publik; në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe kontrollin në Udhëzimin nr. 27 datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", në Udhëzimin e përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 të MAS dhe MFF "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 16.04.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ngritjen e një Grupit të punës për hartimin e Draft Rregullores Financiare të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Të miratojë strukturën e grupit të punës për hartimin e Draft Rregullores Financiare me përbërje si më poshtë:
  1. Haxhirete Sulaj - Administrator i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
  2. Malvina Çiba - Drejtoreshë e Financës dhe Buxhetit
  3. Oltjana Andrea- Drejtoreshë Juridike dhe e Zhvillimit të Kurrikulave
  4. Iris Zala- Përgjegjëse Sektori Prokurimesh në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.
  5. Luiza Shehu- Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore Arkiv/Protokollit
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori, Drejtoritë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek Transparenca Universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT  
ARTUR ÇOBANI**

